



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E BUJQËSISË,  
ZHVILLIMIT RURAL DHE  
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE**

**05 Qershor 2017**

**KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI  
(SHËRBIME KONSULENCE)**

**SHQIPËRI  
PROJEKTI I BURIMEVE UJORE DHE UJITJES**

**Titulli i Detyrës**

**“Shërbimet e Supervizionit për punimet e rehabilitimit të  
Skemës së Ujitjes Murriz –Thanë, Krutje (V1 & V2)”**

**(Nr. Ref. MAFCP/CS/005a)**

**(sipas Planit të Prokurimit)**

**Nr. i identifikimit të Projektit: ID No.: P121186**

**Huaja IBRD: No.: 8211 - AL**

Kjo Kërkesë për Shprehje Interesi është në vazhdim të njoftimit të përgjithshëm për këtë projekt që është publikuar në *Development Business* online më 25 Maj 2010 dhe njoftimit të përgjithshëm të përditësuar, publikuar më 20 Dhjetor 2012, me numër Reference DB No.WB5260-12/12.

Qeveria e Shqipërisë ka marrë financim nga Banka Botërore në shumën ekuivalente 31 milion EUR kundrejt koston së Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes dhe synon të aplikojë pjesë të kësaj shume për Shërbime Konsulente.

Shërbimet e Konsulencës (“Shërbimet”) për “Shërbimet e Supervizionit për punimet e rehabilitimit të skemës së Ujitjes Murriz – Thanë, Krutje (V1 & V2)” (Nr. Ref. MAFCP/CS/005a) përfshijnë Supervizimin e Kontratës së Punimeve Civile për “Rehabilitimin e skemës së Ujitjes Murriz –Thanë, Krutje (V1 & V2)”, që mbulojnë një zonë të caktuar me sipërfaqe rreth 4,300 ha, konkretisht, V1 - 1,300 ha dhe V2 – 3,000 ha.

**Oëllimi Kryesor i kësaj Detyre**

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU) kërkon Shërbime Konsulente të një kompanie/firme të kualifikuar me objektiv të asistojë MBZHRAU (“Klienti”) me Supervizimin e Ndërtimit të Punimeve Civile për “Rehabilitimin e skemës së Ujitjes Murriz –Thanë, Krutje (V1 & V2)”, duke përfshirë rishikimin e projektit, ndryshimet, përmirësimet dhe/ose shtesa në

vizatimet origjinale, kur është e domosdoshme, monitorimin, inspektimin dhe aktivitetet raportuese të supervizimit standart.

### **Detyrat Specifike**

Pritet që Konsulenti do të ndërmarrë detyrat, që përmban kjo kontratë në faza dhe brenda kohëzgjatjes së kontratës, sic specifikohet në Termat përkatëse të Referencës (TRs). Duke asistuar Klientin për përfundimin e kënaqshëm të Punimeve Civile, Konsulenti do të ofrojë shërbime të plota të Supervizionit gjatë zbatimit të Punimeve Civile (8 muaj), dhe që shtrihen, gjithashtu, herë pas here gjatë Periudhës së Përgjegjësisë për Defektet (PPD) (12 muaj), si domosdoshmëri.

Puna e Konsulentit do të fokusohet konkretisht në:

- ✓ Punë me Kontraktorin për të siguruar një fillim të rregullt të punimeve, standarte të larta të sigurimit të cilësisë në ekzekutimin e punimeve dhe përfundimin e tyre brenda afatit të caktuar;
- ✓ Supervizion të hollësishëm të aktiviteteve të zbatimit të projektit të kryera nga Kontraktori për të siguruar përputhshmëri të plotë me projektin inxhinierik, Specifikimet Teknike (sasitë dhe cilësinë) dhe dispozitat e ndryshme të përfshira në dokumentet e Kontratës së Punimeve, si dhe me PMSM (Plani i Menaxhimit Social Mjedisor) në dispozicion për skemat e Krutjes;
- ✓ Dhënia e instruksioneve të nevojshme Kontraktorit, duke siguruar që Kompania e Supervizionit nuk do të japë, pa miratimin paraprak të Klientit, asnjë udhëzim që sipas mendimit të Inxhinierit mund të rrisë shumat e kontratës ose të ndryshojë kushtet e kontratës;
- ✓ Supervizim eficient të ndërtimit nga personel profesional me eksperiencë në praktikat më të mira të supervizimit të ndërtimit dhe menaxhimit të kontratave;
- ✓ Mban të dhena dhe informon me shkrim Klientin në kohën e duhur për të gjitha mangësitë ose parregullsitë e vërejtura gjatë ndërtimit si dhe për masat e marra;

### **Kualifikimet kryesore**

Shërbimet e Supervizionit do të ofrohen nga një Kompani Konsulente ose një Joint Venture e përberë nga ekspertë Ndërkombëtarë dhe Lokalë. Konsulentët e interesuar duhet të kenë eksperiencë të gjërë në Supervizimin e ndërtimeve dhe sigurimin e cilësisë dhe të jenë plotësisht familjarë me politikat e Bankës Botërore për Mbrojtjen, si dhe me udhëzime dhe procedura të tjera të ngjashme. Konsulentët duhet të ofrojnë dëshmi për eksperiencat në Projektimin dhe Supervizimin e projekteve të sistemeve të Ujitjes, përfshirë ato në rajon. Eksperienca e mëparshme me projekte të Bankës Botërore është e dëshirueshme.

Parashikohet që Konsulenti do të krijojë një Ekip Kryesor të fuqishëm të përbërë nga 6 (gjashtë) inxhinierë me eksperiencë të përshtatshme dhe të kualifikuar profesionalisht, me një Ekspert Ndërkombëtar si Menaxher Projekt/Drejtues Ekipi dhe një Inxhinier me kohë të plotë si Zëvendës Drejtues Ekipi. Një Specialist Gjeoteknik me eksperiencë dhe një Ekspert Mjedisor, Social, Shëndeti dhe Sigurie (MSSS) do të jenë pjesë e Ekipit Kryesor.

Stafi i propozuar për të kryer detyrat e besuara Konsulentit do të përbëhet nga:

### **Stafi Kryesor Profesional:**

- ✓ **Menager Projekti (MP)/Drejtues Ekipi (DE);**
- ✓ **Zëvendës Menager Projekti (ZMP)/Zëvendës Drejtues Ekipi (ZDE);**
- ✓ **2 (Dy) Inxhinierë Rezidentë në zonë** (një për secilën vendndodhje të V1 & V2);

- ✓ 1 (Një) Specialist/Inxhinier Gjeoteknik;
- ✓ 1 (Një) Ekspert Mjedisor, Social, Shëndeti dhe Sigurie (MSSS);

dhe

#### Stafi Jo-kryesor:

- ✓ 1 (Një) Inxhinier Hidromekanik;
- ✓ 1 (Një) Inxhinier Hidraulik;
- ✓ 2 (Dy) Teknikë Topograf (Survey Technicians) (një për secilën vendndodhje të V1 & V2);

#### Timing

Parashikohet që periudha e zbatimit për shërbimet e kërkuara të Supervizionit do të jetë **8 (tetë) muaj**, në përputhje me kohëzgjatjen e punimeve për rehabilitimin/modernizimin e ekstremiteve V1 & V2 të skemës së Ujitjes Krutje, Murriz – Thanë. Kërkohet, gjithashtu, që Konsulenti të jetë në dispozicion herë pas here gjatë Periudhës së Përgjegjësisë për Defektet (PPD), që do të jetë **12 muaj** pas përfundimit të zbatimit të Punimeve Civile.

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU) fton firmat Konsulente të pranueshme (“Konsulentët”) të paraqesin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimeve. Konsulentët e Interesuar duhet të japin informacion, që demonstroi që ata janë të kualifikuar të kryejnë shërbimet e kërkuara (*Dokumente që tregojnë statusin Ligjor të Konsulentit, biznesi kryesor dhe vitet në biznes; Organizimi i Konsulentit: teknik dhe menaxherial dhe kapacitetet e tij; Përshtatshmëria për detyrën: eksperiencë e gjërë në Supervizimin e Ndërtimeve dhe sigurimin e cilësisë; Përshkrimi i kontratave të ngjashme, edhe në rajon: Projektim dhe Supervizim i projekteve të sistemeve të Ujitjes: të listohen emrat e projekteve, vlera e kontratës, koha e zbatimit dhe burimi i financimit; Eksperiencë në kushte të ngjashme, disponueshmëri e aftësive të përshtatshme përmes stafit, familiaritet me politikën e Bankës Botërore për Mbrojtjen, broshura, etj.*).

Konsulentet mund të bashkohen me firma të tjera në formën e një Joint Venture ose Nën-konsulencë për të shtuar kualifikimet e tyre.

#### Kriteret e shortlistimit janë:

- ✓ Biznesi kryesor i Konsulentit, organizimi dhe kapacitetet e tij (në rast të JV biznesi kryesor i Kompanisë Drejtuese dhe bashkëpunëtorëve të saj si dhe organizimi dhe kapacitetet e tyre);
- ✓ Përshtatshmëria për detyrën: eksperiencë e gjërë në Supervizimin e Ndërtimeve dhe sigurimin e cilësisë;
- ✓ Eksperiencë e fuqishme në Supervizim dhe Projektim të sistemeve të Ujitjes;
- ✓ Eksperiencë në projekte të ngjashme në rajon dhe familjaritet me politikën e Bankës Botërore për Mbrojtjen;

Vëmendja e Konsulentëve të interesuar tërhiqet në paragrafin 1.9 të Udhëzuesit të Bankës Botërore: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve nën kreditë dhe Grantet e IBRD dhe IDA nga Huamarrësit e Bankës Botërore (Udhëzuesit për Konsulentët) – Janar 2011, duke përcaktuar politikën e Bankës Botërore për konfliktin e interesit.

Një firmë Konsulente do të përzgjidhet në përputhje me procedurat e vendosura në *Udhëzuesit e Bankës Botërore: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore* (Janar 2011), bazuar në metodën e përzgjedhjes “**Kualifikimet e Konsulentit**” (CQS).

Konsulentët e interesuar mund të marrin informacion të mëtejshëm lidhur me Termat e Referencës në website të MBZHRAU: [www.bujqesia.gov.al](http://www.bujqesia.gov.al) ose në adresën e mëposhtëme gjatë orarit zyrtar 08:00 am - 16:30 (nga e Hëna deri të Enjte) dhe 08:00 am – 14:00 të Premten (ora Lokale):

**Z. Ilirjan Lame**

**Menaxher Projekti**

**Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes**

**Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave**

**Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 2, kp. 1001**

**Tiranë, Shqipëri**

**Tel: + 355 4 2226243 – 75129; E-mail: [ilirjan.lame@bujqesia.gov.al](mailto:ilirjan.lame@bujqesia.gov.al)**

Shprehjet e Interesit duhet të dorëzohen në adresën e mëposhtëme jo më vonë se data **20 Qershor 2017 (e Marte), ora 12:00** (ora Lokale):

**Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (zyra e Protokollit)**

**Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 2, kp. 1001**

**Tiranë, Shqipëri**

**Në vëmendje të: Z. Vojo Bregu**

**Sekretar i Përgjithshëm**